

Nga: Dr. Bernard Tahirbegolli, Kordinaror i KosADA

Lënda: Raport i punës i KosADA, për periudhën Janar-Dhjetor 2023

KosADA gjatë vitit 2023 va vazhduar të ushtrij rolin e NADO konform obligimeve të dala nga nënshkrimi i Kodit Botëror për Anti Doping nga Presidenti i Komiteti Olimpik të Kosovës.

Andaj edhe ka vazhduar në investimin në ndërtimin e kapaciteteve për të ushtruar me të gjitha aspektet funksionin e një Organizate Anti Doping në nivel vendi.

Si pjesë e programit nacional për anti doping është vazhduar me edukimin për anti doping dhe vetëdijësimin e komunitetit të sportit gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, duke i realizuar gjithësej 13 seminare dhe 6 webinarë në bashkëpunim me federatat sportive dhe grupet e sportistëve si në vijim:

Federata e Futbollit- 12 seminare, 2 webinarë

Federata e Basketbollit- 1 seminar

Grupi i sportistëve pjesëmarrës në EYOF- 1 webinar

Grupi i sportistëve të përfshirë në listën e regjistruar për testim- 1 webinar

Grupi i sportistëve pjesëmarrës në Lojërat e treta Evropiane- 1 webinar

Federata e Golfit- 1 webinar.

Me qëllim të parandalimit të dopingut në sport dhe monitorimit të respektimit të Kodit Botëror Anti Doping dhe Rregullave Kombëtare Anti Doping janë realizuar gjithësej 90 teste për kontrollë të dopingut, prej tyre 52.2% ishin brenda garave dhe 47.8% jashtë garave.

Testimet për kontrollë të dopingut janë bërë në sportet dhe diciplinat si në vijim: Futboll, Basketboll, Hendboll, Volejball, Çiklizëm, Xhudo, Karate, Atletikë-gjuajtje e gjyles, Atletikë-distanca të gjata, Mundje, Triatlon, Not, Boks dhe Skitari.

Kemi shënuar me 14 Prill, Play True Day me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta “Faik Konica” dhe “Naim Frashëri” në Prishtinë.

Në Maj, janë trajnuar 13 persona për të qenë zyrtar për kontrollën e dopingut.

Prej tyre janë aftësuar 5 persona për të ushtruar rolin e zyrtarit për marrjen e gjakut.

Në kuadër të edukimit që kemi mbajtur, 2 persona i kemi trajnuar si zyrtarë për kontrollë të dopingut nga Shqipëria për AlbNADO në kuader të bashkëpunimit që kemi me ata.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të KosADA kemi marr pjesë në:

simpoziumi vjetor i WADA, në Mars, Lousane, Zvicër.

simpoziumi për TUE i WADA, në Maj-Qershor, Incheon, Korea Jugore

trajnimi për Intelegjencë & Investigim për anti doping, në Korrik, Warshaw, Poloni

Central and Eastern European Anti-Doping Summit, në Tetor, Warshaw, Poloni

takimi me komunitetin e Hendbollit dhe organizatat tjera Anti Doping për çështje të anti dopingut në hendboll të organizuar nga European Handball Federation, në Tetor.

Global Learning and Development Framework e WADA, në Tetor-Dhjetor.

workshopi i XVI për Anti-doping i organizuar nga Laboratori Siebersdors GmbH, në Nëntor, Siebersdorf, Austri.

Gjatë vitit 2023 kemi qenë të obliguar të raportojmë tek WADA përmes Code Compliance Questionnaire për organizimin, funksionimin dhe vprimtarinë e KosADA.

Kemi përditësuar materialet e publikuara në web faqe në lidhje me anti dopingun konform kërkesave të Kodit Botëror Anti Doping.

Kemi standardizuar procedurën për aplikim për leje për TUE.

Kemi standardizuar procedurën për njoftim për shkeljet e mundshme të rregullave anti doping.

Kemi marr pjesë në grupet punuese të MKRS dhe Kuvendit të Kosovës për hartimin e Ligjit për Anti Dopingun.

Kemi marr pjesë në grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore të Ligjit për Anti Dopingun:

Rregullat Kombëtare për Anti Doping

Organizimi dhe Sistematizimi i vendeve të punës në Agjencinë Anti Doping

Komisionet e Përherëshme të Agjencisë Anti-Doping

Rregullore për procedurat e trajnimit dhe certifikimit të personelit për mbledhjen e mostrave për anti doping.